ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Oper. Sistemi,Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	**KOSTT-24-11233-1-2-1**
Nr i brendshëm	**KOSTT023/102-44-24-121**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me pajisje speciale**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.SH. BF ENERGY
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Lakrishte, Rr. Tirana
(Adresa)

Prishtinë — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

045589514 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

FAHREDIN BEKOLLI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@bfenergy-ks.com
(Adresa elektronike)

21.11.2024 — _____
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: Numri i Prokurimit: KOSTT-24-11233-1-2-1 – Titulli Furnizim me pajisje speciale
Njoftimi për kontratë është bërë në datën 24.10.2024 ndërsa hapja publike është bere më datën 18.11.2024.
Vlera e parashikuar 50000€
Kriteri i dhënies ka qenë: Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën 08.11.2024 kemi bere kerkese per rishqyrtim te AK. Data e planifikuar e hapjes se ofertave ka qene 14.11.2024. Njoftimi mbi Vendimin e AK-së per kërkesën per rishqyrtim eshte bere me datën 11.11.2024 dhe njëkohësisht AK ka vazhduar me procedurën e tenderimit duke njoftuar datën e re te dorëzimit te ofertave 18.11.2024.
Me datën 18.11.2024 eshte bere hapja e ofertave te dorëzuara.
Të pakënaqur me këtë veprim të AK-së dhe brenda afatit të rregullte kohorë, po i drejtohemi OSHP-së me këtë Ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne kërkesën per rishqyrtim qe e kemi bere te AK me datën 08.11.2024 kemi potencuar se ne pozicionin 2 te specifikimit teknik, **Aku për presimin e kapikordave**, AK ka specifikuar 3 prodhues Bosch, DeWalt, Makita, mirpo ne ka qene e pamundur te sigurojmë nje oferte konkurruese pasi dy prej ketyre prodhuesve (Makita dhe Bosch) nuk jan fare prodhues te pajisjes se kerkuar, kurse lokalizimi ne keta 3 prodhues ne menyre diskriminuese e pamundeson ofertimin me pajisje nga prodhues te cilet jan te njohur per prodhimin e produkteve ne fjale.
AK e ka refuzuar ankesën tone me pretendimin se nuk kemi ofruar dëshmi te mjaftueshme qe e argumentojnë pretendimin tone. Konsiderojme se AK ne momentin kur i ka përzgjedhur tre prodhues potencial eshte dashur te kete informata te sakta se a e prodhojnë produktin ne fjale këta prodhues te përzgjedhur.
Ne kemi provuar te marrim konfirmim nga shitës potencial te produkteve MAKITA dhe BOSCH por nuk kemi marr ndonjë oferte ne lidhje me kete pozicion, derisa per pozicionet tjera 1,3,4,5 dhe 6, ne te cilat gjithashtu eshte potencuar Prodhuesi: Bosch, DeWalt, Makita, nuk ka pasur problem per sigurimin e ofertave nga cilido prej tre prodhuesve Bosch, DeWalt, Makita.

Sa i përket **poz. 2 - Aku për presimin e kapikordave** ne qëndrojmë bindshëm se AK ka bere diskriminim ne kete rast pasi BOSCH dhe MAKITA nuk e prodhojnë produktin e kërkuar. Pra ose nuk prodhojnë fare Aku per presim te kapikordave, ose nuk prodhojnë Aku per presim te kapikordave per seksion deri 300mm, derisa vetëm baterit e prodhuesve BOSCH dhe MAKITA perdoren nga prodhues te tjerë, sikurse qe jan KLAUKE, CEMBRE, HOLGER CLASEN, etj.
Prodhuesi DEWALT prodhon Aku për presimin e kapikordave per seksion deri 300mm, (nuk jemi te sigurt nese vetëm per tension 20V apo edhe per tension 18V te baterisë, kurse kërkesa e AK eshte per tension te baterisë 18V) mirpo kompania Dona Impex eshte përfaqësuese e kompanisë Dewalt per Kosove dhe ajo eshte vet pjesemarrse ne tenderin ne fjale, andaj edhe nuk pritet qe nga kompania ne fjale te kemi nje oferte te favorshme per te qene ne konkurence me te.

Ne kemi provuar te marrim oferte apo ndonjë konfirmim nga ndonjë nga distributoret e autorizuar ne Kosove. Nga kompania KENETA e cila eshte përfaqësuese e autorizuar per Makita kemi marr përgjigjeje qe nuk kan nje produkt te tille, kurse nga distributoret e BOSCH nuk kemi marr ndonjë përgjigjeje fare.
Ne kemi kërkuar edhe ne google ne lidhje me këto produkte dhe ka rezultuar se Makita dhe Bosch nuk e prodhojnë produktin Aku për presimin e kapikordave me specifikat si i ka specifikuar AK ne dosjen e tenderit. Ne lidhje me prodhuesin Makita, kemi gjetur vetëm Aku për presimin e kapikordave per seksion deri 250mm - **Makita Cordless Brushless Crimping Tool DTC300ZKX1 - Max Capacity 250mm2 dhe Rechargeable Crimping MachineTC300D, 18V, Crimping range 14 to 250mm2** te cilat edhe pse nuk i plotësojnë specifikat e tenderit, ne kemi kërkuar oferte nga distributori i autorizuar KENETA, por na kan konfirmuar se nuk posedojnë pajisje te tilla, andaj nuk kan mundur te ofertojnë kete pozicion, kurse per prodhuesin Bosch nuk kemi gjetur asnjë produkt te ngjashëm, vetëm prodhues tjerë, sikurse KLAUKE, te cilët i shfrytëzojnë bateritë e prodhuesit BOSCH.

Edhe ne katalogjet e prodhuesve MAKITA dhe BOSCH nuk figuron fare produkti i kërkuar nga AK qe ka te beje me pozicionin 2. Meqenese kapaciteti i katalogjeve eshte shume i madh dhe nuk ka mundësi te ngarkimit ne sistemin e e-prokurimit per ankese, me poshtë keni linqet ku mund te shkarkohen katalogjet e prodhuesve MAKITA dhe BOSCH per pajisjet qe punojnë me Aku bateri te tensionit 18V, e nga shihet se nuk gjenden ne katalogjet e tyre pajisjet **Aku për presimin e kapikordave per seksion deri 300mm dhe tension te baterive 18V.**

Linku mund te hapet duke mbajtur shtypur tastin "CTRL" dhe njëkohësisht me maus duke klikuar ne linkun e mëposhtëm!

https://makita.com.sg/e-catalogue/

https://www.bosch-professional.com/gb/en/service/downloads/catalogues/





Me pashte kemi bashkangjitur pjese te katalogut 2024/2025 te prodhuesit MAKITA, per veglat me bateri 18V, ku shihet se prodhuesi MAKITA ka nje shumëllojshmëri te madhe te pajisjeve qe punojnë me bateri 18V, por pajisjet qe kan te bëjnë me presimin e papuqeve te kabllove nuk figurojnë.


18V
LITHIUM-ION
Portable Cut-off
Recipro Saw
Rear Handle Saw
Plunge Cut Saw
Power Cutter
Rotary Hammer
Angle Grinder
Wall Scanner
Slide Compound Miter Saw
Combination Hammer
Caulking Gun
Heat Gun
Circular Saw
Vacuum Pump
Grease Gun
Fan Jacket
Angle Drill
Shear Wrench
Backpack Vacuum Cleaner
Heated Jacket
Cooler & Warmer Box
Heated Base Layer Shirt
Fan Vest
Coffee Maker
Upright Cleaner
Heated Vest
Inflator
Rotary Laser
Worklight
Heated Blanket
LED Worklight
Fan
Bar Light
Radio with Lantern
Worklight
LED Flashlight
Flashlight
Job Site Speaker
Pruning Shears
Job Site Radio
Pruning Saw
18V Lithium-ion
Blower
Wheelbarrow
Hedge Trimmer
Chain Saw
Blower Vacuum
Grass Shear
Lawn Mower
Brad Nailer
Planer
Trimmer
Garden Sprayer
Dust Blower
Portable Vacuum Cleaner
String Trimmer
Robotic Cleaner
Rebar Tying Tool
Rivet Gun
Drywall Saw
Circular Saw
Grass Trimmer
Cleaner
Vacuum Cleaner
Stapler
Cut-Out Tool
Multi Function Power Head
Pin Nailer
Finish Nailer
Cyclone Cleaner
Jig Saw
Plate Joiner
LXT

* Some models are not for local sale

Expand Your Lithium Line Up

AK ne vendimin per refuzim te kërkesës per rishqyrtim ka potencuar edhe se AK nuk ka kërkuar autorizim nga prodhuesi per produktet e kërkuara, por ne realitet ne nuk kemi pasur ankese per kete qeshtje.

Po ashtu, ne vendimin per refuzim te kërkesës per rishqyrtim, AK ka potencuar se te tre prodhuesit e potencuar ne te ardhmen mund te i servisojne produktet tek shitësit/serviset e autorizuara ne Kosove, por kjo mund te vleje per pozicionet 1,3,4,5 dhe 6, por jo edhe per pozicionin 2 pasi nje pajisje te tille nuk ka ne treg.

Perfundimisht, konsiderojm se AK padrejtësisht dhe panevojshëm ka përzgjedhur 3 prodhues per produktin ne fjale, pasi dy prej tyre nuk i prodhojnë pajisjet e kërkuar (Makita dhe Bosch), kurse prodhuesi i trete i potencuar DEWALT i prodhon por kjo krijon nje konkurence jo te barabart pasi përfaqësuesi per Kosove i prodhuesit Dewalt eshte vet pjesëmarrës ne tenderin ne fjale. Gjithashtu, ne treg ekzistojnë prodhues shume me te njohur te cilët prodhojnë enkas produkte te tilla shume kualitative sikurse qe jan KLAUKE (Gjermani), MILWAUKEE (USA), CEMBRE (Itali), ZECK (Gjermani), DRUSEIDT (Gjermani) etj, dhe me kriterin e vendosur nga AK eshte pamundësuar ofertimi me produkte te këtyre prodhuesve te njohur dhe te dëshmuar ne treg me kualitetin e tyre.

AK ne pozicionet 12, 13 dhe 14 gjithashtu ka kerkuar produkte te vetëm nje prodhuesi te caktuar
Poz 12 - Pajisje për matjen e rezistencës se izolimit nga prodhuesi MEGGER
Poz.13 - Instrument universal nga prodhuesi FLUKE
Poz.14 - Kamerë termovizive nga prodhuesi FLUKE
Por ne këto raste, edhe pse AK nuk ka lejuar nje konkurence te mirfillt ne lidhje me këto pozicione, përfaqësuesit per Kosove te këtyre produkteve nuk jan pjesëmarrës ne tenderin ne fjale andaj kemi konsideruar se te gjithë pjesëmarrësit ne kete tender do te ken oferta afërsisht te njëjta nga përfaqësuesit e autorizuar, andaj edhe nuk i kemi potencuar ne kërkesën per rishqyrtim te AK.

Bazuar në krejt këtë që u theksua më lartë konsiderojmë se kërkesa jone per rishqyrtim ka qene e bazuar dhe kërkojmë nga OSHP qe te marr kete vendim:

V E N D I M

APROHOHET si e bazuar Ankesa e OE N.SH. BF ENERGY e datës 08.11.2024, lidhur me tenderin **Numri i Prokurimit: KOSTT-24-11233-1-2-1 – Titulli Furnizim me pajisje speciale**

ANULOHET vendimi i AK - **Oper. Sistemi,Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A. i datës 11.11.2024.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për tenderim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*